

Ftesë për aplikim për trajnime dhe grante

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin “Përmirësimi i punësimimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës” projekt tre-vjeçar (2020-2022), i përkrahur nga Donatori “Bread for the World” nga Gjermania.

Një ndër objektivat e projektit është përkrahja e grave në zonat rurale në ngritjen e aftësive profesionale në përpunimin e frutave dhe perimeve, të cilat më pastaj do të kenë mundësi të gjenerojnë të hyra nga puna e tyre.

Për vitin 2021 aktiviteti për trajnime profesionale dhe grante do të përfshij **Komunën e Kamenicës** duke përzgjedhur 1 grup prej 15 grave të cilat do të përcjellin programin e trajnimeve teorike dhe praktike në **sektorin përpunimit të frutave dhe perimeve** përkatësisht në profilin “Konservues i frutave, perimeve dhe të ngjashme” sipas programit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimit të cilët përmbajnë gjithsej 15 kredi (300 orë mësimore), ku 30% do të jenë mësim teorik dhe 70% mësim praktik.

IADK në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me Komunën e Kamenicës do të investojë në trajnimin e grupit të grave për të rritur njohurit e tyre në përpunimin e frutave dhe perimeve, të cilat do të pajisen me çertifikata për aftësim profesional. Përveç zhvillimit të aftësive, projekti do të parashikojë komponentën e gjenerimit të të ardhurave për kandidaten më të suksesshme nga ato që kanë përfunduar trajnimin dhe janë çertifikuar. Në kuadër të këtij granti do të ngritet një njësi përpunuese me një investim në vlerë prej **12,000.00 €**. Andaj, ftohen gratë/vajzat të aplikojnë për vijimin e trajnimeve për përpunimin e frutave dhe perimeve ku pas përfundimit të trajnimeve dhe certifikimit, do të aplikojnë për njësin përpunuese.

KRITERET PËR APLIKIM DHE PËRZGJEDHJE TË KANDIDATËVE:

- Gratë që jetojnë në zona rurale të Komunës së Kamenicës;
- Gatishmëria për të qenë pjesë e trajnimeve;
- Edukim i pakualifikuar dhe i kufizuar;
- Të jenë të interesuar për të filluar një biznes apo për t’u vetëpunësuar;
- Të jenë me moshë 18-50 vjeç;
- Gratë që janë kryefamiljare kanë përparësi të përzgjedhjes;

Aplikacioni mund të merret dhe dorëzohet në:

- a) Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni këtu: <https://biturl.top/BJzqay>
- b) Zyrën e Drejtorisë për Bujqësi në Komunën e Kamenicës;
- c) Përmes adresës elektronike: hafize.veseli@iadc.org & hasan.cena@iadc.org;
- d) Zyrrat e IADK-së, me adresë Fshati Sfaracak i Ulët, Nr.11, Vushtrri, Kosovë;

Afati për aplikim është i hapur deri me datë **26.04.2021**. Për informata shtesë mund të kontaktoni në **+383 (0) 49 467 531** dhe **+383 (0) 49 973 211**.

Sinqerisht,
Zenel Bunjaku
Drejtor Ekzekutiv

